

Shfaqje Islama

LIBËR I GJUHËS



EMRI DHE MBIEMRI:


KLASA

SHKOLLA

VENDI

SHITETI

dukagjini



Shefkije Islamaj

Libër i gjuhës

Fletore tematike
për nivelin e parë

duk^agjini

**MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS
DHE E TEKNOLOGJISË E KOSOVËS**

**TEKSTE MËSIMORE PËR SHKOLLËN SHQIPE
TË MËSIMIT PLOTËSUES NË DIASPORË**

Autorë/e:

Besa Luzha, Hazir Mehmeti, Lush Culaj, Muhamet Ahmeti-Metis, Nexhat Maloku,
Nexhmiye Mehmetaj, Rifat Hamiti, Rizah Sheqiri, Shefkije Islamaj, Xhevat Sylja.

Hartuese e këtij libri: Shefkije Islamaj

Koordinatorë: Arif Demolli, Basil Schader, Nuhi Gashi

Projekti është mbështetur nga Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut
(Institut i PE -International Projects in Education) dhe
Fondi i Llotarisë i Cyrihut (Lotteriefonds des Kantons Zürich) në Zvicër.

PH Zürich 

**LOTTERIEFONDS
KANTON ZÜRICH**

PËRMBAJTJA

ALFABETI I GJUHËS SHQIPE..... 5

SHKRONJA Ë

Ëndrra 7

SHKRONJAT Ç e Q

Qeni e maçoku..... 9

SHKRONJAT Gj e Xh

Gjyshi 11

SHKRONJAT R e Rr

Në nëntor 12

SHKRONJAT L e Ll

Në pyll 14

DYSHKRONJËSHAT

Ari në ditën e parë në shkollë 16

DIFTONGJET

Vjeshta 18

TINGULLI - FJALA

Në shkollë 20

FJALA – RROKJA

Unë dhe familja ime 24

FJALA – FJALIA

Ku banoj unë 27

EMRI	
Në vizitë në shtëpinë e Zanës	29
NJËJËSI DHE SHUMËSI	
Rina e Lira në treg	32
GJINIA E EMRIT	
Vëllai im	38
EMRAT E PËRGJITHSHËM DHE TË PËRVEÇËM	
Drejtshkrim	41
MBIEMRI	
Kukulla ime	44
FOLJA	
Në garë	49
FOLJET <i>JAM</i> E <i>KAM</i>	53
KOHËT E FOLJES	
Dhelpra me zile	55
FJALIA PYETËSE DHE PIKËPYETJA	
Në Tiranë	59
FJALIA THIRRMORE DHE PIKËÇUDITJA	
Gjyshi humbi!	62

Alfabeti i gjuhës shqipe

Alfabeti i gjuhës shqipe ka 36 shkronja. Ato janë:

A B C Ç D Dh E Ë F G Gj H I J K L Ll M N Nj O P Q R Rr S Sh T Th U V X Xh Y Z Zh

ose, me shkronja të vogla:

a b c ç d dh e ë f g gj h i j k l ll m
n nj o p q r rr s sh t th u v x xh y z zh

Tingujt ndahen në **zanore** e **bashkëtingëllore**.

Alfabeti i gjuhës shqipe ka 7 zanore e 29 bashkëtingëllore.

Zanoret janë tinguj që tingëllojnë vetë.

Zanoret janë:

A E Ë I O U Y

mami Era ora hëna ura ylli

1) Plotëso vendet e zbrazëta me zanoret përkatëse!



B _ b _



_ r _



_ n _



h _ n _



d _ r _



_ r _ th _



S _ r _



_ lb _ r _

**Bashkëtingëlloret janë tinguj që nuk tingëllojnë vetë,
por vetëm së bashku me një zanore.**

Bashkëtingëlloret janë:

B C Ç D Dh F G Gj H J K L Ll M N Nj O P Q R Rr S Sh T Th V X Xh Z Zh

çanta qeni libri shtëpia llamba pylli

2) Plotëso vendet e zbrazëta me bashkëtingëlloret përkatëse!

__y__i __e__a __o__a __ë__a __e__i

__o__i __a__o__u dj__th__



3) Detyra

3a) Sa shkronja ka alfabeti i vendit ku ti jeton tash? _____

3b) Shkruaje alfabetin e vendit ku jeton ti! _____

3c) Cilat shkronja të alfabetit shqip mungojnë? _____

3d) Çfarë shkronjash nuk ka në alfabetin shqip? _____

Shkronja ë

Ëndrra



Ë - në fillim të fjalës

Ë - brenda fjalës

Ë - në fund të fjalës

1) Nënvizo shkronjën ë në shembujt në vijim:

ëmbël	ëmbëlsirë	ëndërr	është	ëndje
qumësht	këpucëtar	nënë	erëmirë	motër
bukë	vajzë	djalë	fushë	mirë

2) A ka në gjuhën e vendit ku jeton ti një tingull si ë-ja?

Shkruaj disa fjalë!

.....

3) Detyrë klase

Në tekstin në vijim plotëso zbrazëtitë me shkronjën ë (Ëndrra, mbrëmë ëmbël, ëndërruar, ëmbëlsirë, që, e ëma, shumë, e ëmbël, unë, u bëra, të, kërkoja, një, copë, dëgjova, zërin, më, ëmbëlsira, që, pashë, në, ëndërr, e ëmbël, që)!

ndrra

Mbr_m_kam _nd_rruar. Në _nd_rr haja _mb_lsir_q_ kishte gatuar e _ma e Valit. Ishte shum_e _mb_l, ashtu siç e dua un_. Sapo u b_ra gati t_k_rkoja edhe nj_cop_, kur d_gjova z_rin e maces sime. U zgjova, por m_mbeti merak _mb_lsira q_pash_n_____. Ah, sa _____ q_ ishte!

4) A të kujtohen fjalë shqipe të tjera me ë? Shkruaji!

.....

5) Shkruajmë apo tregojmë me gojë bashkërisht një tregim ku do të përfshijmë edhe fjalët: **qumësht, ëmbël, ëmbëltoje, nëna, Blerta, gatuan, ve, miell.**



Mësuesja shqipton fjalët **dorë, derë, fëmijë, është, çantë**, ndërsa nxënësit shkruajnë.

Genci shkroi në fletoren e tij: **dor, der, fmij, është, çant.**

6a) A i ka shkruar drejt Genci këto fjalë? Krahsoji me fjalët e shënuara më lart.

6b) Ku ka gabuar Genci?

7) Cilat fjalë me **ë** të duken më të vështira?

Shkruaji dhe mësoji përmendsh!

.....

Mbani në mend!

Zanorja **ë** nganjëherë nuk dëgjohet mirë kur e shqiptojmë, prandaj mund të gabojmë kur të shkruajmë.

Shkronjat ç, q

Qeni e maçoku

Ç



çun



çaj



çelës



çadër



çati



biçikletë



kaçurrele



reçel



papuçe



kaçubë



kuleç



kapuç



qerpiç



lloç



viç

Q

qytet qen qerre qershi qepë
pëlqej shqip shoqe ushqim dyqan
kuq iriq peshq ujë miq

1) Plotëso zbrazëtitë me shkronjat ç e q

(çuni, qeni, që, kaq, diçka, çfarë, çati, maçok)

Qeni e maçoku

- O, a është ky eni yt? _ pyeti Dardani vogëlushin ë po kalonte aty pari.
- Po, imi është, - ia priti ai.
- Pse leh ka shumë ai? – vazhdoi me pyetje Dardani.
- Sepse ka parë di_ka?
- farë ka parë?
- Ka parë macen mbi ati.
- E kujt është macja? Ndoshta është ma_ok?
- Nuk e di. Mund ta dijë uni që po e thërret, sigurisht është i tij.
- Më duket kotele.
- Ndoshta

2) Cilat fjalë me **q** apo me **ç** të duken të vështira? Shëno 6 prej tyre dhe mësoji përmendsh! _____

3) Si shkruhen tingujt **q** e **ç** në gjuhën e vendit ku ti jeton tani?: _____

4) Shkruaj në këtë gjuhë disa fjalë me këto shkronja! _____

5) Shkruaj emrat përkatës nën çdo vizatim!



()



()



()



()



()



()



()



()



()



()



()



()

Shkronjat gj e xh

Gjyshi

Gj

gjel gjyshe gjeraqinë gjirafë gjeth
tungjatjeta ngjyrë vargje magji
zogj qengj

Xh

xhixhë xham xhaketë xhep xhezve xhuxh
filxhan suxhuk zinxhir oxhak tenxhere

1) Plotëso zbrazëtitë me shkronjat gj e xh
(gjyshi, mëngjes, xhezven, gjithë, filxhanët,
gjirafa, xhepi, gjyshin, zoologjik, gjirafës, gjyshit)!

Gjyshi

Në mën_es erdhi _yshi nga fshati. Të _ithë u
gëzuan pa masë. Nëna vuri _ezven mbi shporet,
kurse motra bëri gati fil_anët. Pasi hangrëm mën_es,
bashkë me _yshin, dolëm në qytet. Ishte dëshira ime
të shkonim në kopshtin zoolo_ik. Kur u afruam te
rrethoja _yshi nxori nga _epi një sheqerkë dhe ia
hodhi asaj.

Ajo na shikoi me çudi, ndërsa ne qeshëm. Kush
e di nëse i pëlqeu _irafës sheqerka e _yshit.

2) Cilat fjalë me **gj** apo me **xh** të duken të vështira?
Shëno 6 prej tyre dhe mësoji përmendsh!

.....

3) Si shkruhen tingujt **gj** e **xh** në gjuhën e vendit ku
ti jeton tani?

.....

4) Shkruaj në këtë gjuhë disa fjalë me këto shkronja!
.....

5) Shkruaj emrat sipas fotografive:



()



()



()



()



()



()



()



()



()



()



()



()




()




()



()



()



()



()

Shkronjat r, rr

Në nëntor

R

radio raketë robot rosë erë

liri orë motër zemër

emër flamur nëntor

RR

rrugë rrush rrotë rroba

karrige oborr ëndërr kokërr

1) Detyrë klase

Në tekstin në vijim nënvizo me ngjyra të ndryshme shkronjat **r** e **rr**!

Rina është motra e Ronit.

Riki është qeni i Drinit.

Rrushi është shumë i ëmbël.

Ai nuk del kot në rrugë.

Mos i thej arrat me dhëmbë!



2) Plotëso zbrazëtitë me shkronjat **r e rr** (nëntor, kremtojmë, rroba, rresht, flamurit, veshur, reja, program, teatrit, vjersha, recituar, kaluar, Liria, mbetur, ardhur, oborr)!

Në **nënto**_

Çdo **nënto**_ **k**_emtojmë Ditën e **Flamu**_it. I gjithë qyteti mbushet me flamuj. Ne, nxënësit, të **veshu**_ me **_oba** të **_eja** bëhemi **_esht** dhe shkojmë në sallën e **Teat**_it të Qytetit, ku shfaqet **p**_og_**am** me **vje**_sha, këngë e valle. Vitin e **kalua**_ unë kam **_ecituar** poezinë “**Li**_ia”. Aq shumë fëmijë kishin **a**_dhu_, sa shumë nga ata kanë **mbetu**_ jashtë në **obo**_.

3) Cilat fjalë me **r** apo me **rr** të duken të vështira? Shëno 6 prej tyre dhe mësoji përmendsh! _____

4) Si shkruhen tingujt **r e rr** në gjuhën e vendit ku ti jeton tani? _____

5) Shkruaj në këtë gjuhë disa fjalë me këto shkronja! _____

6) Shkruajmë apo themi bashkërisht disa fjali, ku do të përfshijmë edhe fjalët:

trupi vrapoj bërryli dora syri oborri

Shkronjat l e ll

L

lepur lule lëmsh lakër

flamur flutur pulë klasë

mal gjel pupël

Ll

llambë llastik lloç akullore

mollë dallëndyshe yll

diell qiell portokall

1) Detyrë klase

Në tekstin në vijim nënvizo me ngjyra
të ndryshme shkronjat l e ll!

Lira ka mbledhur lule në livadh.
Blerta valonte flamurin në ballkonin e shtëpisë.
Ylli shkëlqeu lart në qiell.
Blendi po ha akullore.
Halla bleu mollë e portokall.



2) Plotëso zbrazëtitë me shkronjat **l** e **ll** dhe ngyrosi fjalët ku gjenden ato (**V**lera, **B**ledi, pyll, ylberi, mal, doli, dielli, shkëlqeu, qielli, mrekullueshme, mblodhën, lule, llojesh, fluturave, lepurin, lodhën)!

Në **py**__

V_era dhe **B**_edi një ditë shkuan në **py**_. Kishte rënë shi dhe **y**_beri dukej i bukur mbi **ma**_. **Do**_i edhe **die**_i e nga ai **shkë**_qeu i gjithë **qie**_i. Ishte një ditë e **mreku**_ueshme. **Mb**_odhën **_u**_e **_ojesh** të ndryshme, vrapuan pas **f**_uturave, panë **_epurin** dhe u **_odhën** shumë. Ishte një ditë e paharrueshme.

3) Cilat fjalë me **l** apo me **ll** të duken të vështira? Shëno 6 prej tyre dhe mësoji përmendsh! _____

4) Si shkruhen tingujt **l** e **ll** në gjuhën e vendit ku ti jeton tani? _____

5) Shkruaj në këtë gjuhë disa fjalë me këto shkronja! _____

6) Shkruajmë apo themi bashkërisht disa fjali, ku do të përfshijmë edhe fjalët:

Libër tingull baltë fyell çokollatë ylber

Dyshkronjëshat

Ari në ditën e parë në shkollë

Disa tinguj të gjuhës shqipe shënohen me dy shkronja.

Dh Gj Ll Nj Rr Sh Th Xh Zh

1) Shqipto drejt bashkërisht me zë të lartë dyshkronjëshat: **dh, gj, ll, nj, rr, sh, th, xh, zh** dhe më pas fjalët:

dhia



gjeli



llamba



njeriu



thika



xhepi



2) Plotëso vendet e zbrazëta me dyshkronjëshat përkatës!

...ëmbi ...e...i ...o...a ...e...i ...amia ...esi ...ezvja ...apini



3) Lexo dhe nënvizo dyshkronjëshat:

Dita e parë në shkollë

Ari erdhi në shkollë me mamin. Fëmijët e tjerë ishin mbledhur në oborr. Kur panë Arin bashkë me mamin u habitën. Ishte hera e parë që po i shihte shokët e shoqet e klasës. Ata e pritën mirë. Dhe ai u ndie gjithë kohën i lumtur. Në ditën tjetër ai erdhi pa nënën. U bashkua me shokët pa pritur t'i thoshte kush. Në ditët në vazhdim ai mezi priste të vinte në shkollë.

4) Bisedojmë

4a) A ka dyshkronjësha ose trishkronjësha edhe në alfabetin e vendit ku jeton ti?

Shkruaji ato _____

4b) Shkruaj në atë gjuhë ca fjalë me dyshkronjësha ose trishkronjësha! _____

5) Shqipto me zë të lartë fjalët dhe shkronjat që i përbëjnë ato:

shtëpia - sh-t-ë-p-i-a

dhoma - dh-o-m-a

qielli - q-i-e-ll-i

dhurata - dh-u-r-a-t-a

rrota - rr-o-t-a

rreshti - rr-e-sh-t-i

gjuetari - gj-u-e-t-a-r-i

thëllëza - th-ë-ll-ë-z-a

xhuxhi - xh-u-xh-i

njëshi - nj-ë-sh-i

urithi - u-r-i-th-i

shtrati - sh-t-r-a-t-i

Diftongjet

Vjeshta

1) Lexoni me zë fjalët me ngjyrë të kuqe në tekstet e mëposhtme!

Arbri shkroi në fletoren e tij.

Ishte e **diel**. Nuk dëgjohej **fyelli** i bariut. U nisa të shkoja në pyll. Papritmas **dielli** u zhduk pas malit. **Qielli** mori ngjyrë të zezë. Nuk vonoi shumë dhe ia filloi shiu. Shiu ishte i ftohtë e i rrëmbyer (i shpejtë). E kuptova se kishte ikur vera e ishte kthyer vjeshta.

Rina shkroi në fletoren e saj

Filluan shirat. Tryezat tona u mbushën me pemë e nëna përgatiti reçelin. Të **dielën** babai rregulloi stufën, kurse unë e Leka nxorëm rrobat e trasha nga dollapi. Edhe pse dallëndyshet që rrinin afër dritares sime shkuan, mua më pëlqen vjeshta. Po juve, a ju pëlqen?



2) Shkruaj disa fjali për vjeshtën ku do të përdorësh fjalët:

diell, qiell, bie, muaj, luajnë, shkuan.

Fyelli



dielli



qielli



Disa fjalë përmbajnë dy zanore që vijnë njëra pas tjetrës.
Gupet e zanoreve **ua, ue, ye, ie** quhen **diftongje**.

3) Shqipto me zë grupet e zanoreve **ua, ue, ye, ie** dhe fjalët që i përmbajnë këto diftongje:

mësuese grua miell tryezë lexues buall i shqyer bie shkruaj
kërcyes pyes përlyej luaj ndërtues

4) Në vend të pikave vini zanoren që formon diftongjet **ie, ye** dhe **ua**!

di...ll e di...l qi...ll m....ell zi...j gju...j ly...j

i hu...j shkru....j l....aj mu...j ngjy....j gat...aj bi...

5) A të kujtohen edhe fjalë të tjera më diftongjet **ua, ue, ye, ie**? Shkruaji! _____

5) A ka diftongje edhe në gjuhën e vendit ku jeton ti tani? Cilat? Shkruaji ato!
Shkruaj ca fjalë me ato diftongje! _____

Tingulli - fjala

Në shkollë

Unë jam Ari.



E kjo është shkolla ime.

Këta janë shokët e shoqet e mia.

Unë jam Ana.

Unë jam Beni.

Unë jam Diana.

Unë jam Arta.



Ejani, Ejani!



Mirëdita e mirëserdhët! - u thotë mësuesja plot gëzim.

Mirëseugjetëm! – i thonë fëmijët

Kur flasim, ne shqiptojmë fjalë. Pra, të folurit tanë përbëhet prej **fjalëve**. Kurse fjalët përbëhen prej **tingujve**. Për shembull fjala **nënë** përbëhet prej katër tingujve: **n-ë-n-ë**, kurse fjala **zemër** prej pesë tingujve: **z-e-m-ë-r**.

Tingujt e gjuhës shënohen me **shkronja**. Tingujt i dëgjojmë dhe i shqiptojmë, kurse shkronjat i shohim dhe i shkruajmë.

1) Lexo me zë fjalët dhe shkronjat që përbëjnë ato!

Arta - A-r-t-a Ari - A-r-i Ana - A-n-a Beni - B-e-n-i Diana - D-i-a-n-a

2) Thuaj me zë emrin tënd me shkronjat që e përbëjnë atë!

Sa shkronja ka emri yt? Po mbiemri? _____

3) Thuaj edhe emrat e shokëve dhe të shoqeve në të njëjtën mënyrë! _____

4) Shkruaj shkronjat që mungojnë në fjalët nën ilustrime!

_opi shk_lla di_lli li_ri got_ _rusha



Mbani mend

(Gati) secila fjalë ka një kuptim, një domethënie.


molla, lapsi, drita, lodra, qenushi, shkolla, lulja

5) Thuaj disa fjalë në gjuhën e vendit ku ti banon dhe thuaj çfarë kuptimi kanë ato shqip! _____

6) A njeh ti edhe fjalë që vërtet s'kanë kuptim? Sajo disa të tilla! _____

Fjala-rrokja

Unë dhe familja ime



Kjo është familja ime

Babai im quhet **Ilir**. Ai punon në



Nëna ime quhet **Nora**. Ajo punon në



Vëllai im quhet **Lekë**. Ai shkon në



Motra ime quhet **Rina**. Ajo shkon në



Unë jam **Ari**. Emrin ma ka vënë **gjyshja**.

ba-bi në-na I-lir No-ra Le-ka Ri-na A-ri mo-tra gjy-shja

Fjalët ndahen në rrokje.

Rrokja është një tingull ose një grup tingujsh që shqiptohen me një të nxjerrë të frymës.

1) Shqiptoni fjalët sipas rrokjeve dhe shkruani sipas rrokjeve! Si ndihmë, mund t'i përplasni duart në ritmin e rrokjeve.

puna, dita, libri, shpina, gruaja, ora, miku, plaka, lumi, zalli, deti, druri, gjumi, vesa, puna zogu, bredhi, gëzimi, lulet, xixëllonja, lakra, kokrra

pu-na, di-ta, _____

2) Mbani në mend!

Çdo fjalë ka aq rrokje sa ka zanore. Për shembull fjala **shkolla** ka dy zanore **o** e **a**, prandaj ka dy rrokje: **shko-lla**, kurse fjala **papagall** tri zanore, prandaj ka tri rrokje: **pa-pa-gall**.

Vini re!

Ndarja e drejtë

gu-xi-mi
flu-tu-ra
më-si-mi
kla-sa
ta-vo-li-na

Ndarja e gabuar

gux-imi
flut-ura
mës-imi
klas-a
tav-ol-in-a

3) Detyrë

Shkruaj emrin tënd, tre emra të tjerë dhe gjashtë fjalë të tjera duke i ndarë në rrokje!

_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____

Fjala - fjalia

Ku banoj unë?

Fjalia përbëhet prej disa fjalëve.

Fjalia na tregon diçka. Ajo fillon me një shkronjë të madhe dhe mbaron me një pikë (.), me një pikëpyetje (?) ose me një pikëçuditje (!)



Agim Rudi - Plisat

1) Bashko fjalitë me vizë me pjesët e ndara përkatëse



Dielli

im i ri është i kuq.



Zogu

im është i vogël.



Qeni

ime quhet Besa.



Motra

u fsheh pas malit.



Fustani

fluturojnë lart.

2) Lexo me kujdes fjalitë në vijim duke hequr me shenjën X fjalët që nuk duhet të jenë aty dhe pastaj shkruaji në fletore!

Nëna gatuan **lart** drekën.
Vëllai i kuq im është i vogël.
Unë e dua gjyshen lepur.
Lira e Rina laps luajnë.
Dielli iku dhe pas malit.
Drini gjyshit shkon në kopsht.
Arushi gjithashtu i Zanës është i bardhë.
Pulëbardhat fluturojnë dielli mbi det.

3) Shkruaj në fletore tri fjali të bukura për prindërit e tu! _____

4) Shkruaj me shkronja shkrimi fjalitë që shqiptojnë shokët e shoqet e Arit dhe do të kuptosh kush janë ata, ku banojnë dhe çka duan ata më së shumti!

1. Zana Shala:

*Unë banoj në Sheshin e Dëshmorëve, pranë lulishtes.
Më pëlqen shëtitja buzë liqenit.*

2. Martin Shvarc:

*Unë banoj në anën e majtë të Teatrit të Kukullave.
Më pëlqen të shoh shfaqjet e kukullave.*

3. Ana Kranj:

*Shtëpia ime gjendet jashtë qytetit.
Më pëlqen të luaj me top.*

4. Rina Morina:

*Unë banoj afër Muzeut të Qytetit.
Unë e dua vallëzimin.*

5. Selma Teshanj:

*Unë banoj këtu afër, në anën e majtë të shkollës.
Më pëlqen noti.*

5) Formo fjali duke i lidhur grupet e fjalëve sipas kuptimit!

Djaloshi erdhi	e bukur pranvere.
Ishte ditë	kishin çelur.
Babai po lante	ishte ulur macja e vogël.
Zogu kishte	nga shkolla para drekës.
Në karrigen	time veturën e re.
Lulet tashmë	ndërtuar follenë e tij.

6) A mund të formosh fjali me këto grupe fjalësh?

6a) Macja miut pas vrapon _____

6b) adhuron i Beni librat. _____

6c) pushimet shumë për e verës Gëzohem _____

6d) është Në dimri banoj ku vendin i gjatë. _____

FJALIA – TEKSTI

Te gjyshja

Sot Ari ka shkruar në fletoren e tij:

Gjyshja ime jeton në Kosovë. Më merr malli shumë për të e për petullat e saj. Unë e ndiej se edhe atë e merr malli për mua. Çdo verë mezi pres të shkoj tek ajo. Sa shpejt kalon koha atje!



Vini re:

Tekstet gjithmonë përbëhen prej disa fjalive (shumë rrallë vetëm prej një fjalie).

1) Prej sa fjalive përbëhet teksti “Te gjyshja”? _____

Vazhdojmë tekstin

Mësuesja: Po, ju, a ju merr malli për gjyshet?

Ana: Gjyshja ime jeton këtu. Unë e vizitoj çdo të diel.

Beni: Gjyshja ime jeton në Durrës. Çdo verë lahemi në det bashkë. Ç’kënaqësi!

Arta: Mua më merr malli për përrallat e saj. Sa shumë përralla di gjyshja ime!

Diana: Gjyshja ime jeton në Gjenevë. Ajo vjen shpesh te ne me dhurata.

Mësuesja: Pse i kalon koha shpejt Arit në Kosovë? Po juve, a ju ndodh kjo?

Detyrë:

2) Numëro fjalitë në pjesën e dytë të tekstit! _____

3) Shkruaj vetë 3 fjali të shkurtra për gjyshërit! _____

4) Ndaj në rrokje fjalët vijuese:

xhami, luani, domatja, veza, fletorja, shëtitja, shtrati

5) Gjej vetë 8 fjalë dhe shkruaji të ndara në rrokje!: _____

Emri

Në vizitë në shtëpinë e Zanës

Babai i Zanës erdhi nga Tirana. Ai kishte sjellë shumë dhurata. Ne shkua në shtëpinë e Zanës.

Fjalët e shënuara me ngjyrë të gjelbër quhen **emra**.
Këto fjalë emërtojnë **njerëz, kafshë, sende, vende**.

1) Plotëso vendet e zbrazëta me emra përkatës!

emra njerëzish

emra kafshësh

emra sendesh

emra vendesh

nëna
vajza
mjeku

kali
dhia
tigri

libri
kompjuteri
luga

klasa
pishina
shtëpia

2) Si quhen emrat në gjuhën e vendit ku ti jeton tani? _____

3) Shkruaj disa emra në gjuhën e vendit ku jeton ti! _____

4) Në tekstin në vijim nënvizo emrat me ngjyrë të gjelbër!

Të shohim si shkoi vizita në shtëpinë e Zanës



Ne: Mirëdita, axha Agron!

Babai i Zanës: Mirëdita, fëmijë! Si jeni?

Ne: Ju falemi nderit, axhë, mirë jemi. Dëgjuam se jeni kthyer nga Tirana.

Babai i Zanës: Po, po, jam kthyer dje. Më kishte marrë malli shumë për Tiranën e bukur.

Zana: Edhe mua më ka marrë malli për Tiranën, por edhe për gjyshen. Do të shkoj sërish në verën e ardhshme.

Ari: Edhe unë do të shkoj në Prishtinë.

Beni: Edhe unë në Shkup.

Babai i Zanës: Urdhëroni, merrni çokollata e bonbone. Janë prodhuar në Tiranë.

Ne: Ju falemi nderit!

Lira: Sa të mira qenkan!

Rina: Unë po marr edhe një.

Zana: Si ju duket fustani që më ka sjellë babi?

Ne: Sa i bukur! Me shëndet! Të nisemi për në shkollë?

Babai i Zanës: Ju falemi nderit, fëmijë, për vizitën. Ejani prapë.

Ne: Ju falemi nderit edhe juve. Mirupafshim!

Babai i Zanës: Mirupafshim!

5) Sa emra kemi gjetur? _____ Shkruaj ata!

6) Shkruaj emrat e këtyre kafshëve



7) Radhit sipas alfabetit emrat e këtyre kafshëve (në grafikun):

1. delja
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____
8. _____
9. _____

8) Shto emrat e kafshëve sipas ndarjes: kafshë shtëpiake / kafshë të egra:

Kafshët shtëpiake: **kali**, _____

Kafshët e egra: **dhelpra**, _____



Njëjësi e shumësi tek emrat

Rina e Lira në treg

Emri mund të përdoret në njëjës e në shumës.

Numri njëjës tregon një frymor ose një send:

një djalë, një vajzë, një çantë, një gjethe



Numri shumës tregon disa ose shumë frymore ose disa a shumë sende:

disa djem, shumë vajza, katër çanta, njëqind gjethe



shtrati



kukulla



lule



shtretërit



kukullat



lulet



libri



autobusi



librat



autobusët

1) Kërko emrat që janë në numrin njëjës dhe nënvizoji ata!

Vajza mori shportën e shkoi të mbledhë vezët në kotec.

Libri i Arit kishte shumë fletë.

Nëna nxori një lule nga tuba dhe i mori erë.

2) Shkruaj këta emra në shumës:



motra, _____




lapsi, _____



molla, _____



delja, _____



gjethi, _____

3) Shkruaj këta emra në njëjës:



djemtë, _____




zogjtë, _____



petullat, _____



veturat, _____



çantat, _____

4) Plotëso fjalitë me këta emra: qenushi, vajza, djemtë, bletët, nëna, libër,
në njëjës ose shumës!

_____ ushqen patat.

_____ po vraponin pas topit

Mbi lulet fluturonin _____

_____ ime luan në piano

_____ im ka sy të mëdhenj

Unë bleva një _____ .

5) A e di si thuhet njëjës dhe shumës në gjuhën e vendit ku jeton ti? Shkruaj! ____

6) Shkruaj katër fjalë në atë gjuhë në njëjës dhe pastaj në shumës!

7) Në tekstin në vijim ngjyros me të kuqe emrat në njëjës dhe me ngjyrë të gjelbër emrat në shumës!

Rina e Lira në treg

Rina e Lira shkojnë shpesh në treg. Tregu gjendet afër shtëpisë së tyre. Ndonjëherë marrin me vete vëllanë e vogël. Atëherë Rina mban shportën, kurse Lira mban për dore vëllanë.

Sot kanë dalë vetëm ato të dyja. Do të mbushin shportat me mollë, dardha e portokaj. Sigurisht se do të blejnë edhe domate, specat e qepë.

Kështu ato ndihmojnë nënën e tyre.



8) Shkruaji emrat e disa pemëve dhe perimeve që sheh në fotografi! _____

9) Çka do të blejnë Rina e Lira? _____

10) Çka do të blije ti? _____




(_____)



(_____)




(_____)




(_____)



(_____)




(_____)



(_____)



(_____)



(_____)



(_____)



(_____)



(_____)



(_____)



(_____)



(_____)



(_____)

11) Emërto çka sheh në fotografinë më lart dhe pastaj ngjyros ato!

12) Plotëso më tej sipas shembullit të parë!

një mollë

shumë mollë

një domate

shumë domate

një pjeshkë

shumë _____

një spec

shumë _____

një limon

shumë _____

një trangull

shumë _____

një dredhëz

shumë _____

një lakër

shumë _____

një qershi

shumë _____

një karotë

shumë _____

një dardhë

shumë _____

një patate

shumë _____

një kumbull

shumë _____

një fasule

shumë _____

një kivi

shumë _____

një qepë

shumë _____

Gjinia e emrit

Vëllai im

Emri në gjuhën shqipe ka dy gjini kryesore:
gjininë mashkullore dhe gjininë femërore.
Ka edhe ca fjalë me gjini asnjane,se,
për këtë do të mësojmë më vonë!

1) Lexo me vëmendje emrat! Çka keni vërejtur?

babai



nëna



djali



vajza



gjeli



pula



2 Mendo mirë!

2a) Emrat: **babai**, **djali**, **gjeli** kanë diçka të përbashkët. Çka?

2b) Emrat: **nëna**, **vajza**, **molla** kanë diçka të përbashkët. Çka?

Emrat e radhës së parë janë emra të **gjinisë mashkullore**.

Emrat e radhës së dytë janë emra të **gjinisë femërore**.

Edhe emrat **gjyshja**, **motra** e **tezja** janë emra të gjinisë femërore.

Edhe emrat **gjyshi**, **vëllai** e **axha** janë emra të gjinisë mashkullore.

3) Sa gjini ka gjuha e vendit ku jeton ti tash? _____

4) Shkruaj disa shembuj për secilën gjini a) shqip dhe b) në gjuhën e vendit ku jeton ti tash!

a) mashkullore _____

femërore _____

b) mashkullore _____

femërore _____

5) Në tekstin në vijim nënvizo me ngjyrë të kafenjtë emrat e gjinisë femërore, me ngjyrë të gjelbër emrat e gjinisë mashkullore! Shkruaj në fletore emrat e nënvizuar me ngjyra duke i ndarë sipas gjinisë!

Vëllai im

Vëllai im është i vogël. Ai quhet Ilir. Ende nuk ka mbushur një vit. Ka vetëm gjashtë dhembë. Dhembët e tij janë vegjël, ashtu si edhe duart. Mbi shtratin e tij, mami ka vendosur shumë lodra. Lodra e tij e dashur është ariu. Ai sapo ka filluar të ecë. Shpesh rrëzohet në dysHEME. Ka filluar të shqiptojë disa fjalë. Unë nuk e kuptoj kur më kërkon diçka. Vetëm mami e kupton. Ndonjëherë unë kujdesem për të, por ai një ditë ka grisur librin tim të gjuhës. Unë nuk zemërohem me të, sepse ai është ende shumë i vogël.

6) Shkruaj nga tre emra të njerëzve të gjinisë mashkullore e femërore!

Blini

Rina

7) Shkruaj nga tre emra të vendeve të gjinisë mashkullore e femërore!

Durrësi

Prishtina

Mbani në mend!

Jo vetëm emrat e frymorëve (njerëzit, kafshët, shpendët etj.), por edhe emrat e vendeve të vendeve kanë dy gjini (mashkullore e femërore).

Si t'i dallojmë emrat e gjinisë mashkullore nga ata të gjinisë femërore?

Emrat e gjinisë femërore zakonisht mbarojnë me shkronjën **a** ose **ja**
(vajza, nëna, mjekja, lulja, vetura, rruga, fusha).

Emrat e gjinisë mashkullore zakonisht mbarojnë me shkronjën **i** ose **u**:
babi, djali, zogu, punëtori, ariu, dielli, peshku, lumi, kompjuteri.

8) Ndaj dhe shkruaji në dy kolona këta emra sipas gjinisë që kanë: nëna, ketri, Teuta, vogëlushi, jorgani, bleta, gjyshi, fletorja, televizori, dora, syri, tezja, djathi, torta, Agroni, kali, gjyshja, dritarja, pjata, drenusha, xhepi, bora, era, shiu, më-suesja, rruga, qyteti, hunda, gruaja, gruri, ylli, frigoriferi, luga!

Vogëlush

Teuta

Emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm

Drejtshkrim

Lexojmë

Në Kosovë

Kur ishim **verës** në **Kosovë**, vizituam **Pejën**. **Peja** më pëlqen, sepse përmes saj kalon **lumi Bistrica**. Atje jeton **daja** im **Agroni**. Një **ditë** shkua në **Rugovë**. Morëm me vete edhe **ushqimet**: **bukën** **djathin**, **qumështin**. Nuk harruam as **qenin Riki** e as **macen Dori**. Atje takuam **kushërinjtë** tanë **Agimin**, **Gencin** e **Mrikën**. U kënaqëm shumë duke vrapuar nëpër **livadhe**. Mblodhëm **lule**. Kur u kthyem në **qytet**, nga **lodhja**, unë fjeta si **qengj**.

Emrat e përveçëm: **Kosova, Peja, Bistrica, Agroni, Rugova, Riki, Dori, Agimi, Genci, Mrika.**

Emrat e përgjithshëm: **vera, qyteti, lumi, daja, dita, ushqimet, buka, djathi, qumështi, qeni, macja, kushërinjtë, livadhet, lulet, qengji**



1) Vendos në radhë emrat sipas ndarjes: emra të përveçëm, emra të përgjithshëm!

Kosova, vera, Peja, qyteti, lumi, Bistrica, daja Agroni, dita, Rugova, ushqimet, buka, djathi, qumështi, qeni, macja, Riki, Dori, kushërinjtë, Agimi, Genci, Mrika, livadhi, lulja

Emra të përgjithshëm

Lulja

Emra të përveçëm

Genci

2) Vini re ndryshimin kur shkruajmë këta emra! Çka i dallon ata? _____

Mbani në mend!

Emrat e përveçëm (emrat e njerëzve, të kafshëve e të vendeve)
shkruhen me shkronjë të madhe,
emrat e përgjithshëm shkruhen me shkronjë të vogël!

3) Shkruaj shkronjën e madhe ku duhet!

Unë kam qenë në shkup te halla dritë. Më ka pëlqyer shumë lumi vardar që ndan qytetin në dy pjesë. Së bashku kemi vizituar edhe tetovën, dibrën e strugën. Me ne ishte edhe vajza e hallës genta. Ajo mori me vete papagallin pigi. Kam dëshirë të shkoj sërish atje.

4) A shkruhen me shkronjë të madhe emrat e përveçëm në gjuhën e vendit ku jeton ti tash? _____

5) Cilat fjalë shkruhen me shkronjë të madhe në fillim në gjuhën shqipe? Shkruaji disa fjalë që shkruhen me shkronjë të madhe! _____

6) Gjej vetë nga 5 emra të përgjithshëm dhe 5 emra të përveçëm!

Emra të përgjithshëm

Emra të përveçëm

Mbiemri

Kukulla ime

Përveç emrit dhe foljes është edhe një lloj tjetër i fjalëve: mbiemri.

Mbiemri na thotë si e çfarë është dikush ose diçka,
apo si bën dikush diçka:
unë jam **i/e fortë**, nëna ime është **e dashur**, babai gatuan **mirë**

1) Vazhdo të shkruash edhe disa mbiemra

i/e vogël	zemërkeq
i/e mirë	i/e keq
i/e nxehtë	_____
i/e ulët	_____
katror	_____
i/e lehtë	_____
mendjemadh	_____

2) Gjej mbiemrat në fjalitë e mëposhtme duke i ngjyrosur me të gjelbër!

Fustani i kukullës së Zanës është **i kuq**.
Nëna foli qartë e përzemërt.
Klasa jonë është e pastër.
Kjo natë është e qetë.
Lepurushi i Benit është frikacak
Unë kaloj rrugën kur ndizet ngjyra e gjelbër.
Dielli i ngrohtë ra në dritaren e dhomës sime.
Ajo është një vajzë zemërgjerë
Genci është grindavec.

Mbiemrat mund të shoqërohen me një **(i ri, e madhe, e fortë, të bukur)**
dhe pa një **(djalë) punëtor, (vajzë) guximtare, (qen) malor, (lule) fushore**

3) Lidh me shigjetë emrat me mbiemrat përkatës



zogu

e ëmbël



bora

trime



vajza

i vogël



kukulla

e bardhë



djaloshi

e bukur



topi

krenar



gruaja

i rrumbullakët



çokolata

syshkruar

4) Plotëso fjalitë me mbiemrat:

i rrumbullakët, dorëlibër, i kaltër, të zinj, e larme, i hirtë, i lartë

Qielli është _____

Miushi im është _____

Topi është _____

Flokët e mi janë _____

Muri i shkollës është _____


Vëllai im u tregua _____

Ajo flutur është e _____

5) Gjej dhe nënvizo mbiemrat në tekstin që shkroi Rina në fletoren e saj. Ngjyros me të kuqe mbiemrat me një dhe me të kaltër mbiemrat pa një!

Kukulla ime

Unë e dua shumë kukullën **e re** që më ka blerë babi. Ajo është e vogël, **sygjelbër**, flokë ngjyrë gështenje, faqekuqe, ka qafë të gjatë dhe këpucë të vogla. Kur kryej detyrat e shkollës, unë luaj me të. Ndonjëherë nëna më qorton lehtë duke më thënë se tashmë jam rritur shumë që të luaj me kukulla. Unë bëj sikur hidhërohem pak, por lojën e vazhdoj me dëshirë të madhe.



6) Si quhen mbiemrat në gjuhën e vendit ku jeton ti tash? _____

7) Shëno 5 shembuj me mbiemra në gjuhën e vendit ku jeton ti tash: _____

8) Lexoni fjalitë në vijim dhe vëreni dallimet te mbiemrat!

Topi im është **i kuq**.

Bluza ime është **e kuqe**.

Dimri është **i ftohtë**.

Hunda ime është **e ftohtë**.

Deti është **i gjerë**.

Fushat janë **të gjera**.

Ai është peshk **lumor**

Ajo është barkë **lumore**.

Ujku është **dinak**.

Dhelpra është **dinake**.

Mbani mend: **edhe mbiemrat kanë gjininë mashkullore dhe femërore.**

9) Plotëso fjalitë:

Drita është _____

Ariani është _____

Albana është _____

Zogu është _____

Lulja është _____

Fshati është _____

Kutia është _____

Vajza është _____

Bisedojmë

Ari: Çfarë është topi im?

Rina: I kuq dhe i vogël.

Ari: Po këto molla çfarë janë?

Rina: Të kuqe dhe të vogla.



Çka kemi vërejtur?

i kuq – të kuqe

i vogël – të vogla

Mbani në mend: mbiemrat kanë edhe numrin njëjës dhe shumës.

10) Përshkruaj veten tënde me mbiemrat! Si je ti? _____

11) Përshkruaj edhe shokun apo shoqen tënde më të mirë! Çfarë është ajo? _____

Mbiemri më së shpeshti qëndron pas emrit: djali flokëverdhë, fëmijët e gëzuar

12) Pranë çdo emri shto mbiemrin përkatës:

vajzë e vogël

kamion _____

mal i lartë

lumë _____

fushë e gjerë

mollë _____

këmishë e bukur

erë e keqe

vajza të vogla

kamionë të mëdhenj

male _____

lumenj të thellë

fusha _____

mollë të kuqe

këmishë _____

erëra _____

13) Gjej vetë edhe 3 shembuj të tjerë

FOLJA

Në garë

1) Rretho fjalët që tregojnë se çka bën dikush!



Rina po **lexon** një libër.

Bleta fluturon prej lules në lule.



Beni vrapon në fushën e sportit.

Pranvera këndon një këngë të bukur.



Shiu po bie pa pushuar.

Fjalët që tregojnë se çka bën dikush quhen folje.

2) Si quhen foljet në gjuhën e vendit ku ti jeton tash? _____

3) Shkruaj 5 folje në këtë gjuhë! _____

4) Me fjalët: **lexon**, **vrapon**, **shikoj**, **kërcen**, **valëviten**, **thur** plotëso fjalitë në vijim:

Drita _____ librin.



Qingji _____ pas deles.



Unë _____ televizorin.



Bretkosa _____ në ujë.



Flamujt _____ në ajr.



Merimanga _____ rrjetën e vet



5) Lexo tekstin, bëj kujdes për foljet!

Në garë

1. Sot dielli shkëlqen dhe ngroh. Një erë e lehtë lëviz gjethet e pemëve. Pas dreke fëmijët shkojnë në garë të futbollit.
 2. Të gjithë në familjen Morina janë të shqetësuar. U zgjuan edhe Leka e Drini. Ata janë binjakë. Duhet të nguten për garën. Gjyshi u jep këshilla.
 3. Nëna përgatit mëngjesin, ndërsa Leka e Drini hanë shpejt. Blerta shkruan emrat e Lekës e të Drinit në flamuj të vegjël. Babai pajtohet me nënën se ata do të fitojnë.
 4. Vetëm qenushi rri i qetë në vendin e vet. Ai nuk kupton se çka po ndodh.
 5. Ja, edhe, djemtë tanë u nisën për garën.
- Të gjithë shpresojnë se ata do të luajnë mirë.



Vër re: Edhe fjalë **jam** dhe kam **janë** folje.
Unë jam nxënëse e mirë; ai është djalë i keq; ato kanë një qen, ...

6) Formo nga dy fjali me foljet “jam” dhe “kam”

7) Bisedojmë për tekstin e mësipërm:

7a) Çka bëjnë nëna, Leka, Drini e Blerta? Po qenushi ç'bën?

Përgjigjet të jepen në këtë formë:

Nëna _____ mëngjesin.

Leka e Drini _____ për garën.

Blerta _____ emrat në flamujt të vegjël.

7b) Çka bën babi e çka qenushi? Nënvido foljet! _____

7c) Si është koha, çka ndodh në natyrë? Nënvido foljet! _____

8) Vendos pas secilit emër nga një folje (shushuritin, u kënaqën, pikëlon, ngroh, cicërojnë, fluturojnë):

dielli _____

shiu _____

lumi _____

zogjtë _____

fluturat _____

fëmijët _____

9) Lexo dhe nënvizo foljet në këto vargje!

“Viu, viu, fryn veriu,
Nëpër xhama troket shiu,
Viu, viu, era s’ndalet!
Bora zbardhi gjithë malet!”

10) Bëj një listë me 7 folje shqip – përkthim në gjuhën e vendit ku jeton ti tash!

Foljet **jam** dhe **kam**

1) Lexo me zë!

Unë **jam** nga Kosova.
Ti je i mençur.
Ai është i vyeshëm. / Ajo është shumë e bukur.
Ne jemi të gëzuar për ardhjen tuaj.
Ju jeni nga Zvicra?
Ata janë fëmijët tanë. / Ato janë valltare të mira.

Unë kam një papagall.
Ti ke këpucë të reja.
Ai ka sy të gjelbër. / Ajo ka dëshirë të vallëzojë.
Ne kemi shumë libra.
Ju keni shtëpi të madhe.
Ata kanë fushë të tenisit. / Ato kanë çanta të bukura.

Foljet **jam** dhe **kam** janë folje dhe tregojnë një gjendje -
- çka kam ose çka jam unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato.

2) Cilat janë foljet **jam** dhe **kam** në gjuhën e vendit ku jeton ti tash? _____

3) Shkruaj nga një fjali me foljet **jam** dhe **kam** a) shqip, dhe b) në gjuhën e vendit ku jeton ti tash!

a) shqip _____

b) në gjuhën e vendit _____

4) Vendos në tekstin e mëposhtëm foljet **jam** dhe **kam**!

Ti _____ një nxënës shumë i mirë.



Unë _____ një lepur të bardhë.



Susi _____ nga Gjermania.



Ajo _____ gërsheta të gjata.



Ju _____ ende të vegjël.



Leka _____ veshur pallton e dimrit.



Ne _____ të pikëlluar për sëmundjen e gjyshes.



Lejleku _____ sqepin e gjatë.



5) Shkruaj nga tri fjali me **jam** dhe me **kam**!

Unë jam _____

Unë kam _____

Ti _____

Ti _____

Ai/ajo _____

Ai/ajo _____

Ne _____

Ne _____

Ju _____

Ju _____

Ata/ato _____

Ata/ato _____

Kohët e foljes

Dhelpra me zile

Folja paraqitet përmes kohëve.

Kohët kryesore të foljes janë: e tashmja, e shkuara dhe e ardhmja. Ka edhe kohë të tjera.

1) Vëreni me kujdes ndryshimin e formës së foljes!

unë jam	unë kam	unë lexoj	unë shoh
unë isha	unë kisha	unë lexova	unë pashë
unë do të jem	unë do të kem	unë do të lexoj	unë do të shoh

2) Çka keni vërejtur?

Format: unë **jam, kam, lexoj, shoh** tregojnë foljen në kohën e tashme.

Koha e tashme tregon diçka që bëhet ose ndodh tash.

Format: unë **isha, kisha, lexova, pashë** tregojnë foljen në kohën e shkuar.

Koha e shkuar tregon diçka që është kryer ose ka ndodhur para çastit kur flasim.

Format: unë **do të jem, do të kem, do të lexoj, do të shoh** tregojnë foljen në kohën e ardhshme.

Koha e ardhme tregon diçka që pritet të kryhet ose të ndodhë.

3) Gjeni vetë tre shembuj të tjerë!

K. e tashme

Gjyshi lexon.
Bie shi.

K. e shkuar

Gjyshi lexonte.
Binte shi.

K. e ardhme

Gjyshi do të lexojë
Do të bjerë shi.

4) Lexo fjalitë e mëposhtme! Gjej foljet dhe shëno se në cilën kohë janë paraqitur ato!

Sot jam e gëzuar.

Koha e _____

Dje erdhi tezja me dhuratat.

Nesër Ari do të shkojë në teatër.

Vjet për pushime ishim në Vlorë.

Tani po shikoj televizor.

Pasdite do të luajmë futboll.

Mbani mend!

Përrallat tregohen me kohën e shkuar. Ato fillojnë me fjalët:


Na ishte njëherë ..., Kishte qenë njëherë..., Na ishte ç'na ishte ... etj.

5) Lexojmë bashkë përrallën. Nënvizoni foljet në kohën e shkuar!

Na ishte një here një dhelpër. Ajo kishte një zile që i varej në bisht dhe kur ecte tringëllinte tin, tin, tin. Një ditë vendosi të shkonte në vresht, ku kishte shumë rrush. Mezi u fut nëpër vrimën e murit që rrethonte vreshtin. Hoqi zilen dhe e vari në degën e një peme dhe hëngri rrush derisa u ngop. Pastaj e zuri gjumi. Kur u ngrit, hëngri prapë rrush. Dhe kështu vazhdoi shumë kohë. Një ditë e zbuloi i zoti i vreshtit dhe e përzuri duke e rrahur me dru.

Një vit më vonë dhelpërs iu kujtua se e kishte lënë zilen në degën e një peme afër vreshtit. Kur shkoi ta merrte, e pa se dega ishte rritur, dhe nuk arrinte ta merrte. I luti të gjithë me radhë që t'ia arrinin zilen por kot.

Atëherë me shumë mundime e bindi pemën. Ajo u përkul, e mori atë dhe e vuri në bisht sërish.



6) Plotëso fjalitë e mëposhtme me foljet:

tregoj,
lexoj,
do të shkojmë,
ishim,
lau,
shikon,
do të mbushë!

Dje Blini **erdhi** më herët

Unë po _____ librin e gjuhës.

Pas tre muajsh Zana _____ tetë vjet

Gjyshi po _____ televizorin.

Pasdite _____ në teatër.

Nëna _____ rrobat tona.

Vjet ne _____ në bjeshkë.

7) Shkruaj nga tri fjali në kohën e tashme, në kohën e shkuar dhe në kohën e ardhme!

Fjala pyetëse dhe pikëpyetja

Në Tiranë

Vitin e kaluar Ari shkoi bashkë me prindërit në Tiranë. Dy ditë me radhë shëtitën anekënd qytetit. Bënë fotografi të bukura të sheshi Skënderbe, buzë lumit të Lanës, të Muzeu i Qytetit. Vizituan edhe një shkollë fillore. U kënaqën me moshatarët e tyre duke biseduar, duke lozur dhe duke shëtitur. U kthyen me kujtime shumë të bukura.



1) Bisedojmë duke dhënë përgjigje me shkrim:

1a) Kush shkoi në Tiranë? _____

1b) Ku gjendet Tirana? _____

1c) Çka panë ata në Tiranë? _____

1d) Çfarë u pëlqeu më së shumti në Tiranë? _____

1e) A ke qenë ti ndonjë herë në Tiranë? _____

Kur pyesim, fillojmë fjalinë me **a** (a shkojmë tani?)
ose me fjalët pyetëse: **kush, ku, kur, kë, kujt, sa, si, çfarë, pse, çka.**

2) Plotëso fjalitë në ilustrimin që është dhënë më poshtë me fjalë pyetëse: kush, ku, kur, kujt, kë, sa, si, çfarë, pse, çka.!



1. Kush

po këndon?



2. _____

është qeni yt?



3. _____

ka në pjatë?



4. _____

mollë ka në enë?



5. _____

fillon mësimi?



6. _____

është fletorja?



7. _____

bën vogëlushi?



8. _____

qan çuni?



9. _____

e ka vizatuar?



10. _____

po e thërret lopa?



Në fund të fjalisë pyetëse duhet të vëmë pikëpyetjen (?).

[illegible]

Fjalia thirrmore dhe pikëçuditja

Gjyshi humbi!

Lexojmë bashkërisht me kujdes. Vini re fjalitë e ngjyrosura me ngjyrë të gjelbër.

Gjyshi humbi!

- Mami, mami! - thirri Ari me zë të lart. -A nuk më dëgjon?

- Ç'ke që thërret me aq zë? Po ti qenke djersitur, or bir! Uh, sa më trembe!

- i tha mami

- E pashë gjyshin teksa po vija nga shkolla. E thirra, por ai sikur nuk më dëgjo. Kishte shumë nxënës aty pari dhe befaz nuk e pashë më. - i tha Ari i mërzitur.

- Ndoshta, të është dukur, -vazhdoi mami.

- O, jo, jo. Unë ia njoha kapelën. Si mund ta ngatërroj gjyshin, unë!

- Kush e di, mund të ketë pasur ndonjë punë!

Papritmas u dëgjua zilja.

- Zilja! Kush mund të jetë?

- Oh, erdhi gjyshi! Mami, mami, erdhi gjyshi!

- Ua, sa mirë! Na trembe si shumë, more gjysh! Ari të kishte parë njëherë, pastaj i kishte humbur nga shikimi.

- Po si mund të vija, more bir, te ti pa dhuratën që të kisha premtuar! Hyra në librari dhe e bleva këtë. Ja, merre e lexoje! Pastaj herën tjetër bisedojmë.

- Oh, faleminderit gjysh! Qenkan përrallat shqiptare, për të cilat më ke folur aq herë!

Gjyshi i përkëdheli flokët Arit me dashuri dhe u ul në karrige për të pirë kafënë.



1) Bisedojmë duke dhënë përgjigje me shkrim:

1a) Ku humbi gjyshi? _____

1b) Pse u tremb Ari? _____

1c) Çka i kishte sjellë gjyshi Arit? _____

1d) A keni lexuar ju ndonjë përrallë shqiptare?

**Kur shprehim habi, gëzim, frikë, zemërim shkruajmë
pikëçuditje në fund të fjalisë.**

2) Gjej fjalitë që përfundojnë me pikëçuditje në tekstin e lexuar dhe shkruaji më poshtë! _____

3) Si quhet pikëçuditja në gjuhën e vendit ku jeton ti tash? _____

4) Shkruaj vetë 5 fjali ku do të vësh pikëçuditjen! _____

Shefkije Islamaj
LIBËR I GJUHËS
Fletore tematike

Botimi i parë

Botues:
Shtëpia botuese "DUKAGJINI" - Pejë

Për botuesin:
Agim Lluka

Redaktor teknik:
Lavdim Beqiri

Tirazhi: 5.000 kopje
Formati: 205x285

U shtyp në shtator 2010
në shtypshkronjën "Dukagjini" - Pejë
www.dukagjinigroup.com

Katalogimi në botim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

37:811.18(075.2)

Islamaj, Shefkije
Fletore tematike për nivelin e parë: libër i gjuhës
Shefkije Islamaj. - Botimi 1.-Pejë: Dukagjini, 2010.
- 64 f. ilustr. me ngjyra; 30 cm.

ISBN: 978-9951-05-235-1

*Lejohet për botim me vendim të Ministrisë së Arsimit,
të Shkencës dhe të Teknologjisë të Kosovës, nr 293/2, të datës 22.06.2010*